



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a
L42222001F

Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

Përmbajtja

Pasqyra e Pozicionit Financiar	3
Pasqyra e Performancës.....	4
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital.....	5
Pasqyra e Flukseve Monetare	6
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare.....	7
1. Hyrja	7
2. Baza e përgatitjes.....	7
3. Politikat kryesore kontabël	8
4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimieve	14
5. Aktivet afatgjata materiale.....	15
6. Parapagime	15
7. Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera.....	16
8. Mjete monetare	16
9. Kapitali.....	16
10. Detyrimet	17
11. Shitjet	17
12. Shpenzime operative.....	18
13. Shpenzime personeli	18
14. Të ardhurat financiare.....	19
15. Shpenzime tatim fitimi.....	19
16. Ngjarje të mëvonshme	19

TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Aktivet			
Aktive afatgjata të trupëzuara	5	133,968	170,291
Aktive afatgjata jomateriale		1,659,609,988	1,659,609,988
Aktivet Afatgjata		1,659,743,956	1,659,780,279
Parapagime	6	19,276,258	21,992,658
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	878,855	1,119,081
Mjete monetare dhe ekivalente me to	8	900,557	4,371,199
Aktivet Afatshkurtra		21,055,670	27,482,938
Totali i Aktiveve		1,680,799,626	1,687,263,217
Kapitali			
Kapitali aksionar	9	204,840,311	204,840,311
Rezerva	9	(4,934,210)	(5,207,342)
Fitimi neto		729,447	273,132
Totali i Kapitalit		200,635,548	199,906,101
Detyrimet			
Detyrimet tregtare dhe të tjera	10	1,222,168,056	1,225,089,214
Detyrimet afatgjata		257,996,022	262,267,902
Totali i Detyrimeve		1,480,164,078	1,487,357,116
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		1,680,799,626	1,687,263,217

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 10 deri 19.

Këto pasqyra financiare janë haruar nga Jon Consultancy sh.p.k dhe janë miratuar dhe nënshkruar nga aksionari i Shoqërisë më 17 Shkurt 2018.

Artan Xhori



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

Pasqyra e Performancës

	Shënim	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhurat			
Të ardhurat nga shitjet	11	2,975,252	6,327,344
Totali i të ardhurave		2,975,252	6,327,344
Shpenzime			
Shenzime operative	12	(2,913,925)	(5,083,889)
Shpenzime personeli	13	(3,707,081)	(4,285,356)
Shpenzime amortizimi	5	(36,323)	(38,234)
Totali i shpenzimeve		(6,657,329)	(9,407,479)
Të ardhura/(shpenzime) financiare			
Të ardhura financiare	14	4,421,580	3,411,204
Shpenzime financiare	14	(9,956)	(57,838)
Totali i shpenzimeve financiare		4,411,624	3,353,366
Fitimi para tatimit			
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15	729,447	273,132
Fitimi / (humbja) e vtit		729,447	273,132
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave/(shpenzimeve) gjithpërfshirëse		729,447	273,132

Pasqyra e performancës duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet faqet 10 deri 19.



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në L.EK

Pasqyra e Ndrysimeve në Kapital

	Kapital i neshkruar	Rezerva	Fitimi / Humbja e mbartur	Total
Gjëndja më 1 janar 2016	100,000	-	(5,207,342)	(5,107,342)
Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në kapital	-	-	-	-
Kontributet nga pronarët	-	-	-	-
Kontributet totale nga pronarët	204,740,311	-	-	204,740,311
 Humbje totale gjithëpërfshirëse për vitin				
Humbje për vitin		273,132	273,132	
Humbje të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi				
Humbje totale gjithëpërfshirëse për vitin				
Gjëndja më 31 dhjetor 2016	204,840,311	-	(4,934,210)	199,906,101
 Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në kapital				
Kontributet nga pronarët	-	-	-	-
Kontributet totale nga pronarët	-	-	-	-
 Humbje totale gjithëpërfshirëse për vitin				
Humbje për vitin	-	-	729,447	729,447
Humbje të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	-	-	-	-
Humbje totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	204,840,311	-	(4,204,763)	200,635,548

Pasqyra e ndrysimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në fagot 10 den.



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

Pasqyra e Flukseve Monetare

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / Humbja për periudhën para tatimit		729,447	273,132
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizim	5	36,323	38,234
<i>Ndryshimet në:</i>			
- shpenzime ne avance		2,716,400	(21,992,658)
- llogaritë e arkëtueshme		240,226	141,432
- tregtare dhe të tjera të pagueshme		2,921,158	-
- detyrime të tjera		-	1,225,080,565
Fluksi neto i parave të përdorura në aktivitetet operative		801,238	1,203,540,705
Fluksi monetare të përdorura në aktivitetet investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata të trupëzuara		-	(208,525)
Parapagime ne investime ekonomike		-	(1,544,601,988)
Fluksi neto i parave të përdorura në aktivitetet investuese		0	(1,544,810,513)
Flukset monetare nga aktivitetet e financimit			
Hua afatgjata		(4,271,880)	140,394,562
Rritja e kapitalit aksionar		-	204,740,311
Fluksi neto i parave nga aktivitetet e financimit		(4,271,880)	(345,134,873)
(Rënie)/rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(3,470,642)	3,865,065
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		4,371,199	506,134
Paraja dhe ekuivalentët e saj në 31 dhjetor		900,557	4,371,199

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 10 deri 19.



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

1. Hyrja

a) Informacion i përgjithshëm

Towers Network Albania (ka ndodhur ndryshimi i emrit nga Hightel Towers Albania me 22.02.2018) u themelua me 22.10.2014 fillimisht si shoqeri me pernjegjesi te kufizuar per te kaluar me pas ne shoqeri aksionere me 05.12.2016

Vendndodhja kryesore e aktivitetit është në Tiranë, Shqipëri. Ne 31 Dhjetor 2017 Shoqëria kishte në përbërjen e saj 6 Aksionere, Administratori i shoqerise eshte Z. Artan Xhori.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve në fushën e transmetuesve radiofonik dhe televiziv, operatoreve te sherbimeve multimediale, shoqerive qe operojne ne Teknologjine e Komunikimit te Informacionit (ICT) etj.

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria kishte 1 punonjës. Me 31 Dhjetor 2016, Shoqeria kishte 2 punonjës.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara ("SKK-të").

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Gjithë informacioni finansiar paraqitet në Lek përvèç rasteve kur tregohet së është paraqitur ndryshe.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

3. Politikat kryesore kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a. Aktivet dhe detyrimet financiare

i. Aktivet financiare jo-derivative

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme tregtare e të tjera dhe depozitat në datën që ato kanë ndodhur. Të gjitha aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Çdo interes në aktivet financiare të transferuara qe është krijuar apo mbajtur nga Shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim më vete.

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen së bashku dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit finanziar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejte ligjore për të paraqitur shumat neto dhe ka për qellim ose për të mbyllur veprimin me to mbi një bazë neto, ose për të realizuar shitjen e aktivit dhe blerjen e detyrimit në të njëjtën kohë.

ii. Llogaritë e arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë regjistruar në një treg aktiv. Aktive të tillë njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, plus çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejt me to. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me metodën e kostos së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo rënje të vlerës.

iii. Mjetet monetare dhe ekivalenet me to

Mjetet monetare dhe të ngjashmet me to përbëhen nga tepricat e parave të gatshme dhe depozitave pa afat, ose me maturimin fillestar prej tre muaj ose më pak. Mjetet monetare janë përfshire me kosto të amortizuar në pasqyra.

iv. Detyrimet financiare jo-derivative

Shoqëria fillimisht njeh detyrimet financiare në datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

Shoqëria çregjistron një detyrim finansiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anullohen apo humbin vlefshmërinë e tyre. Shoqëria ka këto detyrimeve financiare jo derivative: të pagueshme tregtare dhe të tjera dhe detyrime të tjera.

Detyrime të tilla financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, plus çdo kosto transaksi i që lidhet drejtpërdrejt më të. Pas njohjes fillestare këto detyrime financiare maten me metodën e kostos së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

b. Inventari

Inventarët maten me vlerën më të ulet mes kostos dhe të vlerës neto të realizueshme.

Kosto e inventarit bazohet në metodën 'FIFO' dhe përfshin kostot e ndodhura gjatë blerjes së inventarëve, prodhimit ose shndërrimit, kosto të tjera të kryera për lëvizjen e tyre në vendin dhe gjendjen e gatshme për përdorim.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit minus çdo kosto të vlerësuar përfundimin dhe shpenzimet e shitjes.

c. Aktivet afatgjata të trupëzuara

i. Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata të trupëzuara maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimin e tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementeve dhe rikthimin e tokës në gjendjen origjinale. Programet (software) e blerë të cilët janë pjesë tërësore në funksionalitetin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e kësaj pajisje.

Kur pjesë të një objekti të aktiveve afatgjata të trupëzuara kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si objekte të veçanta (përbërës kryesorë) të aktiveve afatgjata të trupëzuara.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një objekti të aktiveve afatgjata të trupëzuara përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën e mbartur të ndërtesës dhe pajisjeve, dhe janë të njohura si të ardhura neto në kategorinë e të ardhurave të tjera, në fitim ose humbje.

ii. Kostot vijuese



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata të trupëzuara i shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhen me ketë element do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me saktësi. Kostot e mirëmbajtjeve ditore të aktiveve afatgjata të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

iii. Zhvlerësimi

Vlera e amortizueshme e një zëri të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përdorur metodën lineare për të gjitha aktivet materiale mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë që prej ditës së parë të muajit pasues të muajit të blerjes.

Normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria janë si më poshtë:

Kategoria e asetve	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Mjete Transporti	Metoda lineare	20%
Makineri & Vegla Pune	Metoda lineare	20%
Pajisje Zyre & Informatike	Metoda lineare	25%

Vlera e mbetur,jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit, rishikohen dhe rregullohen kur është e përshtatshme, në çdo vit financiar. Ndryshimet në metodën e amortizimit do njihen si ndryshime në rregullat e kontabilizimit.

d. Aktivet jo-materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivet e paprekshme që kanë jetë të dobishme të fundme janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Shpenzimet e zhvillimit kapitalizohen vetëm nëse shpenzimet mund të maten në mënyrë të besueshme, produkti ose procesi është teknikisht dhe komercialisht i realizueshëm, përfitimet e ardhshme ekonomike janë të mundshme dhe Kompania synon të ketë dhe ka burime të mjaftueshme për të përfunduar zhvillimin dhe për ta përdorur ose për të shitur asetin. Përndryshe, ajo njihet në fitim ose humbje si të ndodhë. Pas njohjes fillestare, shpenzimet e zhvillimit maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

ii. Shpenzimet e mëvonshme

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet ekonomike të ardhshme të mishëruara në aktivin specifik me të cilin lidhet. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë

TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

shpenzimet për emrin e mirë dhe markat e krijuara brenda vendit, njihen në fitim ose humbje si të ndodhura.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e reduktimit të reduktimit dhe norma e amortizimit është 5%. Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlerat e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe përshtaten nëse është e përshtatshme.

e. Transaksionet në monedhë të huaj

Fitimi ose humbja nga konvertimi i zérave monetarë në monedhë të huaj është diferenca që rezulton nga një numër i dhënë njësish të një monedhe të huaj në Lekë me kurse këmbimi të ndryshëm. Aktivet dhe detyrimet jo-monetary të shprehura në monedhë të huaj përkthehen në Lekë me kursin e këmbimit të datës së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerën e drejtë ripërkthehen në Lekë me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Fitimet ose humbjet që vijnë nga ndryshimet e kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit zyrtarë për monedhat kryesore të përdorura në përkthimin e zérave të bilancit kontabël të cilat shprehen në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë (Leku ndaj kurseve të huaja të këmbimit):

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
1 EUR	132.95	135.23
1 USD	111.10	128.17
1 GBP	149.95	157.56

f. Zhvlerësimi

Aktivet financiare

Një aktiv finansiar, i cili nuk regjistrohet me vlerën e drejte të tregut përmes pasqyrës së të ardhurave, vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që tregon së mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv finansiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidence objektive zhvlerësimi tregon së një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit finansiar dhe kjo mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshije pamundësi apo vështirësi të një klienti për të realizuar pagesën, ristrukturim të një detyrimi ndaj Shoqërisë me kushte që Shoqëria nuk do të hynte në raste të tjera, ose treguese që një klient do të shpallë falimentim. Shoqëria konsideron evidence të zhvlerësimit të llogarisë së kërkesave të arkëtueshme, si në nivel specifik të aktivit ashtu edhe në grup. Të gjithë klientët specifike vlerësohen për zhvlerësim specifik.

Gjate vlerësimit në grup, Shoqëria përdor të dhënat historike të probabilitetit të mos pagesës, kohën e mbledhjes dhe shumen e humbjes së ndodhur, të rregulluar sipas gjykimeve të Drejtimit

nëse kushtet e tanishme ekonomike dhe të kreditimit janë të tillë që humbjet aktuale të kenë mundësi të jenë më të mëdha apo më të vogla sesa të vlerësuara nga të dhënat historike.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi finanziar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferençë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit finanziar. Humbjet

nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe paraqiten si llogari provizioni kundrejt llogarive të arkëtueshme. Një humbje nga zhvlerësimi mund të anullohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njojur zhvlerësimi. Anullimi apo pakësimi i zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje.

Aktivet jo-financiare

Vlerat e mbartura të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përvèç inventarëve dhe aktiveve tatile të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse ka evidence të tillë, atëherë vlera e rikuperueshme e aktivit vlerësohet. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare ("njësi gjeneruese e mjeteve monetare ose NJGJMM") është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot për t'u shitur. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen për të dhënë vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi përparrat tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe Rreziqet specifike të aktivit. Me qëllim testimin për zhvlerësim, aktivet që nuk mund të testohen në mënyre individuale grupohen së bashku në njësinë më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vijueshëm që janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo grupeve të tjera të aktiveve.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi e tejkalon shumën e rikuperueshme të vlerësuar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njoitura në lidhje me NJGJMM shpërndahen për të zvogëluar vlerën e mbartur të aktivit në njësi (grup njësish) në varësi të peshës së secilit.



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

Humbja nga zhvlerësimi rishikohet në çdo datë raportimi për tregues qe humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi kthehet nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme.

Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën, në të cilën vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbetur të tij që përcaktohet nga vlera neto e tij pas amortizimit, nëse nuk ka humbje nga zhvlerësimi.

g. Provigjionet

Një provigjion njihet kur Shoqëria , si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose strukturor, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohet një fluks dalës të mirash ekonomike për të shlyer detyrimin. Provigjionet llogariten duke skontuar fluksen e ardhshme monetare më një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe Rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi kohor i skontimit njihet si kosto financiare.

h. Të ardhurat

Të ardhurat nga shitja e mallrave në rrjedhën e aktivitetave të zakonshme maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, neto nga kthimet, uljet tregtare dhe të vëllimit. Të ardhurat njihen kur ekzistojnë prova bindëse, zakonisht në formë të mallrave të konfirmuara dhe të dorëzuara, se rreziqet e mëdha dhe përfitimet e pronësisë i janë transferuar blerësit, pagesa e shumës është e mundshme, kostot e shoqëruara dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhduar të Drejtimit me mallrat, dhe shuma e të ardhurave mund të maten me besueshmëri. Nëse është e mundur që do të ofrohet ulje dhe shuma mund të matet me besueshmëri, atëherë zbritja njihet si reduktim i të ardhurave nga shitja kur ato njihen. Koha e transferimit të risqeve dhe përfitimeve varet nga kushtet specifike të procesit të shitjes.

i. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në kohën kur ato ndodhin.

j. Përfitimet e punëmarrësve

Planet e kontributive të përcaktuara

Shoqëria merr pjesë në kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore që jepin përfitimet e pensionit për punonjësit e saj pas daljes në pension. Detyrimeve për kontribute të tilla për të përcaktuar planet e pensioneve njihen si shpenzime në fitim ose humbje, kur ka detyrim.

TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

Autoritetet lokale janë përgjegjëse për sigurimin dhe përcaktojnë pragu ligjor minimal për pensionet në kuadrin e një plani pensionesh të përcaktuara.

Planet e kontributeve të përcaktuara

Shoqëria njeh si detyrim shumen e pazbritur për shpenzimet e vlerësuara e të lidhura me pushimet vjetore që priten të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

Përfitime afatshkurtëra

Detyrimet afatshkurtra që punonjësit përfitojnë, maten në një bazë të paskontuar njihen si shpenzime në momentin e kryerjes së shërbimit.

k. Tatimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në fitim ose humbje, përvçese kur lidhet me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar nga të ardhurat e tatushme, duke përdorur normat tatile ose fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mire të bërë të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatile fitimin, nëse ka. Ky tatim llogaritet duke përdorur normën tatile ose të fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit. Tatimi fitimi aktual i pagueshëm ose i arkëtueshëm kompensohen vetëm në qoftë se kritere të caktuara përbushen. Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatile.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimieve

Provigionimet dhe Eksposozimet Fiskale

Për të përcaktuar nëse një provigjon duhet të regjistrohet, Shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregon së ka ndonjë rrezik të identifikuar dhe të matshëm në flukset monetare të ardhshme, për shembull ato që lidhen me tatile dhe gjobat. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë së ka pasur një ndryshim në kushtet ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me humbje të mundshme. Drejtimi përdor vlerësimet bazuar në humbje të shkuara dhe prova objektive të zhvillimeve aktuale të ngjashme kur bën vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si sasinë edhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferençat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës me humbjet.



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

5. Aktivet afatgjata materiale

Aktivet materiale	Mobilje & Pajisje zyre	Pajisje Informatike	TOTALI
Kosto			
Më 1 janar 2016	-	-	-
Shtesa	150,000	58,525	208,525
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2016	150,000	58,525	208,525
Shtesa	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	150,000	58,525	208,525
Zhvlerësim i akumuluar			
Më 1 janar 2016	-	-	-
Shpenzime për vitin	(25,000)	(13,234)	(38,234)
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2016	(25,000)	(13,234)	(38,234)
Shpenzime për vitin	(25,000)	(11,323)	(36,323)
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	(50,000)	(24,557)	(74,557)
Vlera e mbartur			
Më 1 janar 2016	-	-	-
Më 31 dhjetor 2016	125,000	45,291	170,291
Më 31 dhjetor 2017	100,000	33,968	133,968

6. Parapagime

Parapagime më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Diferenca e vlerës vjen si pasojë e anullimit të faturës së SIGAL UNIKA GRUOP (blerje përjashtuar, pa tvsh, duke qënë se fatura ishte për siguracioinin e kullave, por me pas marrëveshja u annullua dhe nuk u vu në zbatim.



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferencia
Shpenzime te periudhave te ardhshme	19,276,258	21,992,658	2,716,400
Totali	19,276,258	21,992,658	2,716,400

7. Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferencia
Klientë	627,000	432,000	(195,000)
Tvsh e kreditueshme	251,855	592,420	340,565
Të tjera të arkëtueshme	-	94,661	944,661
Totali	878,855	1,119,081	240,226

8. Mjete monetare

Mjetet monetare dhe ekivalenjtë e tyre janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferencia
Para në banka	885,113	4,348,038	(3,462,095)
Para në arkë	15,444	23,161	(7,717)
Totali	900,557	4,371,199	(3,470,642)

9. Kapitali

Kapitali i regjistruar i Towers Network Albania sh.a është 204,840,311 lekë dhe më 31.12.2017 zotërohet nga 6 aksioneret: Uni-Com, HTI Italia, Samir Mane, Top Channel, TV Klan dhe Artan Xhori.



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferencia
Kapitali aksionar	204,840,311	204,840,311	-
Rezerva ligjore	-	-	-
Rezerva të tjera	(4,934,210)	(5,207,342)	273,132
Fitimi i vitit	729,447	273,132	456,315
Totali	200,635,548	199,906,101	729,447

10. Detyrimet

Vlerat e lidhura me llogaritë e pagueshme tregtare janë drejt furnitorëve dhe janë të lidhura me blerjen e aksioneve te Shoqërive të kontrolluara si dhe huave të dhëna nga aksionerët si dhe nga shoqeria e kontrolluar nga Towers Network Albania.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferencia
Furnitorë	1,222,063,647	1,224,926,447	2,862,800
Paga të punonjësve	27,527	27,527	-
Kontributet e sigurimeve	34,672	46,331	11,659
TAP	42,210	45,778	3,568
Tatim i mbajtur në burim	-	43,130	43,130
Detyrime nga aksioneret	245,921,104	249,985,908	4,064,804
Detyrime nga PN	12,074,918	12,281,994	207,076
Totali	1,480,164,078	1,487,357,116	7,193,038

11. Shitjet

Të ardhurat nga shitjet paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferencia
Të ardhura nga shitjet	2,975,152	6,327,244	(3,352,092)
Totali	2,975,152	6,327,244	(3,352,092)



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

12. Shpenzime operative

Shpenzirnet operative përbëhen si me poshtë

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferenca
Qira	644,000	976,825	(332,825)
Energji elektrike & Lend djegse	59,863	9,273	50,590
Sherbime bankare	45,205	199,293	(154,088)
Taksa dhe tarifa vendore	145,674	307,767	(162,093)
Blerje Materiale ndihmese	141,370	41,537	99,833
Shpenzime postare dhe telekom	6,000	4,500	1,500
Sherbime financiare	935,700	1,529,800	(594,100)
Te tjera me kupona	294,854	-	294,854
Sherbime bashkepronesie	36,416	77,224	(40,808)
Shpenzime Juridike	221,640	1,638,122	(1,416,482)
Mirembajtje dhe riparime	-	13,129	(13,129)
Gjoba, demshperblime,te tjera	32,956	286,419	(253,463)
Shpenzime pritje	350,247	-	350,247
Totali	2,913,925	5,083,889	(2,320,387)

13. Shpenzime personeli

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferenca
Pagat e personelit	3,417,663	3,897,650	(479,987)
Kontributet shoq. & shënd.	289,418	387,706	(98,288)
Totali	3,707,081	4,285,356	(578,275)

Shoqëria me 31 dhjetor 2017 kishte 1 punonjës (2016: 2).



TOWERS NETWORK ALBANIA sh.a

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë të shprehura në LEK

14. Të ardhurat financiare

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferencia
Fitime nga këmbimet valutore	4,421,580	3,411,204	1,010,376
Humbje nga këmbimet valutore	(9,956)	(57,838)	47,882
Totali	4,411,624	3,353,366	1,058,258

15. Shpenzime tatum fitimi

Shoqëria nuk ka pasur shpenzime për tatum fitimin ne vitin 2017 dhe 2016. Shoqëria nuk ka parapaguar tatum fitim për vitin.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Diferencia
Fitimi para tatumit	729,447	273,132	456,135
Norma e aplikuar e TF	15%	15%	-
Shpenzime të pazbritshme	678,057	10,359	646,488
Tatum fitimi i vitit	-	-	-
Parapagime	-	-	-
Tatum fitimi i arkëtueshëm	-	-	-

Shpenzimet e pazbritshme lidhen me shpenzime që sipas Ligjit Shqiptar nuk mund t'i zbriten llogaritjes së fitimit/humbjes së tatushme dhe si rjedhojë dhe shpenzimit të tatum fitimit aktual.

16. Ngjarje të mëvonshme

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose dhënie informacionesh shpjeguese në pasqyrat financiare.

